



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1147/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. **KI98/16**

Parashtrues

Fazile Morina

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP, nr. 7/2016, të 31 marsit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gérxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fazile Morina nga fshati Hade (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Selatin Ahmeti, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP, nr. 7/2016, të 31 marsit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, për të cilin parashtruesja pretendon se i ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 27 qershor 2016, parashtruesja nëpërmjet postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtares, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues, Gresa Caka-Nimani dhe Selvete Gérxhaliu-Krasniqi).
7. Më 19 korrik 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe Gjykatës Supreme i dërgoi një kopje të kërkesës.
8. Më 31 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović kryesues të Kolegjit shqyrtares në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit më 9 shtator 2016.
9. Më 4 korrik 2017, Kolegji shqyrtares shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përbledhja e fakteve

10. Më 29 qershor 2006, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), me Vendimin nr. 05/313/2, ka refuzuar kërkesën e parashtrueses për kompensim të shpenzimeve të qirasë dhe ushqimit për arsyet zhvendosjes së saj nga shtëpia në fshatin Hade për shkak të rrëzikut të rrëshqitjes së dheut.
11. Më 9 tetor 2008, me Aktgjykin A. nr. 1739/2006, Gjykata Supreme e Kosovës në procedurën e konfliktit administrativ aprovoi padinë e parashtrueses si të bazuar, anuloi vendimin e MMPH-së dhe çështjen e ktheu në rivendosje në MMPH.

12. Më 27 gusht 2010, me Aktvendimin KRJA 7/2008, Gjkata Supreme e Kosovës hodhi poshtë si të palejuar kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të parashtruar nga MMPH-ja.
13. Më 13 maj 2011, me Vendimin nr. 313-4/o8, në procedurën e rivendosjes MMPH-ja përsëri refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses për kompensim të shpenzimeve të qirasë dhe të ushqimit.
14. Me një datë të paspecifikuar, parashtruesja kontestoi vendimin e MMPH-së dhe paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti i Konflikteve Administrative (DKA).
15. Më 9 tetor 2014, me Aktgjykimin A. nr. 444/11, Gjkata Themelore në Prishtinë - DKA, refuzoi si të pabazuar padinë e parashtrueses.
16. Më 17 nëntor 2014, parashtruesja paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore.
17. Më 9 tetor 2015, Gjkata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin AA. nr. 128/2015, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore - DKA A. nr. 444/11.
18. Më 21 nëntor 2015, parashtruesja ka paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve esenciale të procedurës së LPK-së.
19. Gjkata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. A. (U) nr. 13/2015 (aktvendimi mungon në shkresat e lëndës), e ka hedhur poshtë si të palejuar revisionin e paditëses, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA. nr. 128/2015, të 9 tetorit 2015, duke theksuar se kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë nuk mund të paraqitet revizioni.
20. Më 25 janar 2016, parashtruesja ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke theksuar se kërkesën për revizion e kishte orientuar gabimisht në vend të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm.
21. Më 31 mars 2016, Gjkata Supreme, me Aktvendimin RJ-UZVP nr. 7/2016, hodhi poshtë si të palejuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA. nr. 114/2014, të 6 majit 2015.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesja e kërkesës ka pretenduar se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse nuk kanë konstatuar drejt faktet e rastit dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridikzioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 7, i Kushtetutës, i cili parasheh:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësish se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

26. Së fundi, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

27. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses përmbush kriteret e nenit 113.7 sa i përket palës së autorizuar dhe shterjes së mjeteve juridike, është parashtruar brenda afateve të nenit 49 të Ligjit dhe i plotëson kushtet për t'u shqyrtuar në Gjykatë.

28. Gjykata vëren se parashtruesja ka pretenduar në mënyrë specifike se me Aktvendimin e Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP. nr. 7/2016 asaj i është shkelur e drejta kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm(neni 31 i Kushtetutës), i cili ka përbajtjen si në vijim:

Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gjëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

29. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247, dhe B. *Vidal kundër Belgikës*, 22 prill 1992. f. 33, seria A. nr. 235).
30. Gjykata vëren se argumentet e parashtrueses lidhur me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm konsistojnë në konstatimin të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykatat e rregullta gabimisht kanë konstatuar se parashtruesja nuk është zhvendosur nga shtëpia e saj gjatë procesit të menaxhuar nga” Zyra për Implementimin e Projektit Hade, gjatë periudhës prej 18 nëntorit 2004-14 shkurt 2005”. Gjithashtu, parashtruesja ka theksuar se Gjykata Supreme gabimisht e ka kalkuluar afatin ligjor kur ka hedhur poshtë si të paafatshme, kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
31. Gjykata konstaton se Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e parashtrueses ndaj vendimit të MMPH-së, ndër të tjera, kishte arsyetuar “*Gjykata gjithashtu vëren se gjatë inspektimit të familjeve në vendbanimet e përkohshme të zhvendosura nga zona me koeficient të lartë të rrezikshmërisë të fshatit Hade, në procesverbalin e datës 18.05.2006, tek familja e Fazile Morinës tanë paditësja si kryefamiljare, është konstatuar se Fazile Morina, tanë paditësja jeton me qira në banesën e vëllaut të sajë në Ulpianë, mirëpo e njëjta nuk ka kontratë mbi qiranë, gjithashtu në procesverbal konstatohet se e njëjta nuk figuron në listën e personave të zhvendosur nga fshati Hade*”.
32. Gjykata Themelore më tej kishte theksuar se: “*Nga kjo gjendje e fakteve gjykata vëren se i padituri me rastin e marrjes së vendimit kontestues, drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, nga shkaku se bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se paditësja nuk i ka plotësuar kushtet për përfitimin e ndihmës financiare për qira dhe ushqim nga shkaku se e njëjta nuk është zhvendosur bashkë me personat e tjerë nga fshati Hade, zona e rrezikshmërisë, të cilën zhvendosje e ka bërë e paditura si dhe e njëjta me rastin e inspektimit nuk ka poseduar kontratë mbi qiranë për banim të përkohshëm, kushte këto përfitimin e të drejtës financiare për qira dhe ushqim*”.
33. Gjykata vëren se, duke refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, këtë gjendje faktike e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit kur vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë –DKA.
34. Gjykata më tej konstaton se aktvendimet e Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën për revizion dhe për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë ishin hedhur poshtë nga kjo gjykatë, për mospërmbushje të kritereve ligjore procedurale dhe nuk u morën me merita e rastit.

35. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit apo Gjykata Themelore në Prishtinë, përvèç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
36. Gjykata më tej thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
37. Në të vërtetë, Gjykata thekson se detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procedurat përkatëse të gjykatave të rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ose kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrarë (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, paragrafi 16 Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës i 30 qershorit 2009; *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34 Aktgjykimi GJEDNJ i 16 dhjetorit 1992; *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, paragrafi 68 Aktgjykimi GJEDN i 6 dhjetorit 1988.).
38. Gjykata vëren se parashtruesja ka pasur mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e saj në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, duke përdorur mjetet e ankimit ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore, andaj, procesi si tërësi nuk mund të cilësohet si arbitrar apo i padrejtë.
39. Në rrethanat e rastit, Gjykata nuk gjen se vendimet e gjykatave të rregullta janë arbitrarë apo janë tregues i shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, aq më tepër, kur të gjitha pretendimet e parashtruesit kishin të bënин për shkelje ligjore dhe jokushtetuese me ç'rast parashtruesja në asnje mënyrë nuk paraqiti prova se si dhe në cilat rrethana e drejta e pretenduar kushtetuese është shkelur.
40. Si përfundim, Gjykata konkludon se kërkesa në baza kushtetuese nuk është arsyetuar *prima facie* dhe se faktet e paraqitura në kërkesë nga parashtruesja nëasnje mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të një të drejte kushtetuese andaj, në përputhje me rregullin 36 (2) a) dhe b), kërkesa deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) a) dhe b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 korrik 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi